

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	633-25-7025 -5-2-1
Nr i brendshëm	633-025-049-521

Sa i përket tenderit për: : **LOT 1 - NDERTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE ZALLQ,**
LOT 2 -NDERTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE VRELLE - PROJEKTE DY VJEÇARE
(633-025-049-521)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

TONI INGJINJERING SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Llapushnik, Magjistralka, M9, Gllogoc

(Adresa)

Drenas (Gllogoc)

(Vendi)

13050

(Kodi postar)

+383 44 249 730

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

Malush Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

toni.ingjinjering@hotmail.com

(Adresa elektronike)

07.08.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Niveli i shkëlqimit dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkëngjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues Komuna e Istogut, me date 07.06.2024 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës:

LOT 1 - NDERTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE ZALLQ,
LOT 2 -NDERTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE VRELLE - PROJEKTE DY VJEÇARE (633-025-049-521)

1. Procedurë e hapur,
2. Kontrate publike,
3. Punë, Vlerë e mesme
4. Vlera e parashikuar e kontratës 102,000.00 euro
5. Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve, ka qen me date 14.08.2025 ora:14:00,
Vendi: Zyra e Prokurimit

Me date 01.08.2025 është publikuar ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës

**-LOT 1 - NDERTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE ZALLQ,
LOT 2 -NDERTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE VRELLE - PROJEKTE DY VJEÇARE
(633-025-049-521) Komuna e Istogut.** Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi terhek dosjen e tenderit permes E-prokurimi

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nuk është apliku

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me kriteret e AK- Autoriteti kontraktues – Komuna e Istogut dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim kundër; Kërkesave diskriminuese mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2:

Pas pranimit të dosjes nga platforma e-prokurimi dhe analizimit të saj, ne si OE të interesuar ne bazë të nenit 4.1.26 të LPP-se, për të marrë pjesë në këtë procedure, kërkojmë sqarime shtese për 80% të kriterëve të cilat mendojmë se janë diskriminuese, të pa drejta dhe të pa nevojshme lidhur me aktivitetin relevant të prokurimit në kundërshtim të plotë me nenin 1, pika 1; 2 dhe 3; nenin 6, pika 1, nenin 7, pika 1; 2 dhe 6; neni 28, pika 2 dhe 10, **si dhe Neni 69 paragrafi 6.4** të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës në fuqi.

Kriteret në vijim për të cilat kërkojmë sqarime shtese janë të kundërligjshme dhe duhet larguar nga kriteret e përzgjedhjes sepse, mendojmë se janë diskriminuese, të pa drejta dhe të pa nevojshme me aktivitetin relevant të prokurimit (ne bazë të natyrës së punëve dhe paramasës së dhënë në dosje të tenderit, e që dote kryhen në kontratë 80% të tyre janë diskriminuese) të cilat po cekim si fakte dhe argumente.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2:

Keni kërkuar:

Sipas ktyre kerkesave ne piken 9.1 dhe 9.2 - Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka staf teknik të mjaftueshem dhe atë min. 10 punëtorë. Të jenë të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë.

Dëshmia 3. Lista e punetoreve duhet te dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Kontratat e punetoreve, si dhe **Lista e punëtorëve nga ATK.** Certifikata SSHP

KËRKOJMË QË TË HIQET kërkesa Ku kerkohet si dëshmi Lista e punëtorve të deklaruar në ATK sepse është në kundërshtim me **Neni 69 paragrafi 6.4 të dhe Nenit 7** Barazia në trajtim dhe JO-diskriminim të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës në fuqi. Të bashkëlidhur e keni një Opinion të Kundër korrupsionit të lëshuar ndaj komunës prej nga jam edhe Unë për hjekjen e kërkesës për Listën e punëtorëve të lëshuar nga ATK.

Kërkesa 4. Stafi ndihmës a) Inxhinier I diplomuar I makinerise me 5 vite përvojë pune pas diplomimit I çertifikuar si specialist i Saldimit IWS. b) Një person i çertifikuar për sistemin e integruar të menaxhimit dhe sigurise se trafikut rrugor.

-Ne tash do tju kerkoj edhe do ju njoftojm per secilen paisje apo per secilin personel te stafi i kerkuar:

Ne ketë ofertë të shpallur nga ana e juaj si AK. nuk kemi te bejm fare me piken a) apo me ingjiner te makineris dhe i qertifikuar si specialist i saldimit IWS.Arsyeja ë se ne paramasen e kti projekti nuk kemi as nji pozicion qe na duhet te salldojm apo ti percjellim punet e salldimit,por kemi furnizimi apo blerja dhe vendosja e shtyllave metalike apo paisjev tjera-shiqo paramasen **(Blerja, bartja dhe montimi i shtyllave dhe 2 trupave ndriques se bashku me nje drite sinjalizuese ne maje me ngjyre te kalter, qe realizohet me ankerim me lartesi h=9,0m, komplet me lire dykraheshe ku (liren e gjate duhet edhe nje litar per mbajtje) 1x2,5m dhe 1x0,75m tek pjesa e trotuarit (shiqo skicen), me elemente përcjellëse),por e njejta kerkesë është ne te gjitha pozicionet.** Ju njoftoi se ky inxhinjer qe është cekë te kerkesa 4. Pika a) i perket udhëzinav metarlugjike dhe fabrikave prodhuese te metaleve.

Prandaj kerkoi qe kjo kerkesë te largohet nga kerkesa si kriter i perzgjedhjes.

Kërkesa 4. Stafi ndihmës b) Një person i çertifikuar për sistemin e integruar të menaxhimit dhe sigurise se trafikut rrugor.

Me vendosje te ndriqimit publik nuk kemi te bejm me sistemet e integruar te menagjimit dhe siguris se trafikut rrugor,kjo ka nji kuptim tjeter qe neve per punet e tilla nuk na sherben .Per arsye se ne paramasë jan vendos pozicionet qe te vendosen shenjat dhe barelat

per pjesen e vendit punues,e ne paramasë nuk kemi te bejm me sistem te integruar.

Prandaj kerkoi qe kjo kerkese te largohet nga kerkesa si kriter i perzgjedhjes.

Kto pika qe i ceka duhet te largohen si kriter te perzgjedhjes sepse nuk kan te bajnë me punet e kti projekti dhe si pasojë edhe mi marr si staf punues nuk kan kurfar mundsie me u angazhu ne ket projekt dmth: skan punë te natyres se tyre,prandaj duhet te largohen sepse perveq qe nuk mundemi ti angazhojm ne punet e kti projekti te kta kemi edhe nji kosto te lartë si kompani pa pas mundsi me i angazhu.

-Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe profesionale qe ju si AK keni kërkuar, janë në kundërshtim të plotë me nenin 28, pika 2 dhe 10 e LPP-se, ngase Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv, por AK i juaj nuk ka përfshirë një projekt apo elaborat se cilat punë sipas paramases së dhëne do të përfundohen në te ardhmen, për me tepër këto kërkesa janë diskriminuese

sepse Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Në vijim do ti paraqesim pretendimet tona sa i përket kriterëve diskriminuese dhe te pa nevojshëm të vendosura nga AK në NJK dhe DT.

-Kërkesat mbi mundësitë teknike:

Kërkesa 5. Lista e mjeteve dhe mekanizmi të ofruara nga Operatori Ekonomik a) 1 (një) Kamion kiper me kapacitet min. 10m3 b) 1 (një) Kamion kiper me vinç peshë bartëse min. 10 ton c) 4 (kater) Automjete me shportë Speciale për punë në ndriçimin publik, me ateste per siguri ne pune d) 1 (një) gjysmërimorkio kompresor ajri (per thyerje te pjeseve te forta) max. 700kg – që tërhiqet e) 3 (tri) Kamjonetë Dubelkabinë për bartjen e materialit dhe punëtorëve ë) 1 (një) pick up f) 1 (një) rimorkio për bartjen e automjeteve (pasha bartese min. 13 ton) g) 1 (nje) Lugë Ngarkues – Piruner max. 6 ton. h) 3 (tre) bager (eskavator germues) me zingjir min. 6 ton - max. 8.5 ton i) 1 (nje) Kove për perzierjen e betonit me sistem hidraulik. j) Mjete adekuate për kryerjen e punimeve si Makinë ngjeshëse min. 480 kg (min. 3 copë), Prerëse asfalti dhe betonit (min. 2 copë), Ngjeshëse Kanali-Zhabicë (min. 3copë), apart për nivele (min. 1 copë)

Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 70% të mjeteve (paisjeve) të kërkuara.

Vazhdojm per **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale,9.2-Kerkesa 5. te Mekanizmi punues-**

Kërkesa 5. Paisjet te cilat duhet larguar nga kriteret e ksaj dosje te tenderit per te cilat nuk kan zbatim ne bazë te natyres se projektit dhe paramases se dhen ne dosje te ofertes jan:

1. **Pikat: a,b** –te kto automjete apo paisje te ju largohet termi minimal dhe maximal,sepse kufizon perdorimin e mekanizmit te shum OE te cilet posedojn mekanizma apo makineri per ket lami te punes.

3. **Pika d)nji gjysum rimorkjo** Kompresor ajri per thyrje max. 700kg-kjo paisje duhet te largohet per arsye se nuk kemi punë sipas paramases ose ti largohet termi max. Dhe percaktimi 700kg. Sepse te kompresori matet kompresimi i ajrit ne bar e jo me kg te trupit te kompresorit,prandaj kerki qe ta rregulloni termin e kerkeses sepse edhe ne vlersim te ofertave krijohen pa qaresi.

4. **Pika g)nji lugë ngarkuese-Piruner max.6 ton** - te largohet per arsye se nuk kemi punë sipas paramases dhe kjo paisje nuk gjen zbatim ne teren ku dote kryhen punimet dhe nuk kemi qka me ngarku,- **prandaj kjo paisje duhet largu si kriter i perzgjedhjes.**

5.**Pika h) keni kerku 3 bagera 6 ton deri ne 8.5ton –qka na duhen tre bagera per 900 m kanal. Kerkoi te largohet se paku nji dhe te largohen termet 6 ton dhe 8.5 ton sepse edhe 4.5 ton apo 4 ton kryejn punë.**

6. **Pika j)** Makin ngjeshese min. 480 (min 3 copë)- Kjo është e tepert per 250 m kubza 3 ngjeshese –kerkoi **ie largohen 2 copë** te jet veten nji,sepse po shifet qe jan te pa nevojshme.

Te pika j) te largohen si kriter te perzgjedhjes: nji preres i asfaltit, Zhabicat te gjitha te largohen si kriter i perzgjedhje sepse skemi ngjeshje te kanalit sepse asht kerkesa e paisjes per ngjeshje e qka me ba me 6 ngjeshese,aparat per nivele min 1copë,te kjo kerkesë aparat per nivele lind pytja qfar nivele sepse kemi lloj lloj niveles - **prandaj kto paisje duhet largu si kriter i perzgjedhjes. sepse** (ktu po shihet se te gjitha kto paisje te pa nevojshme ju ka ofru ndoni analfabet qe nuk din as qka ka me u punu edhe si punohet), **dhe i kemi vrejt se qfar pune bajn sidomos ne ndriqime publike qe kam deshmi).**

Te pika j) edhe te termi qe është cekë:Udhëheqsi i grupit ti ket se paku 70% te mjeteve te kerkuara. (me duket edhe per ket është i perzier analfabet sepse nuk ekziston ne ligj te prokurimit kjo kerkesë).

prandaj edhe kjo termologji duhet largu si kriter i perzgjedhjes.

Duke i analizu kto kerkesa se ato te stafit punues dhe te mekanizmit po shifet se jan kerkesa te imponuara nga ndoni OE qe ska te baj fare me implementin e kti lloi projekti.

Kërkesa 6. a) ISO 14001 2015; b) PAS 99 2012; c) ISO 50001 2018; d) ISO 3834-2 2006

Te kerkesa 6. Kërkoi te largohen si kriter te perzgjedhjes kto ISO: 1) **Te largohet b) PAS 99 2012 dhe 2) Te lagohet pika d) ISO 3834-2 2006** .Arsyja është sepse ne ket projekt nuk kemi te bëjm me prodhim te as nji materiali,por kemi te bejm me blerje dhe vendosje te materialeve sipas paramases. **prandaj kerkoi qe pika b dhe pika d te ISO te largohen si kriter i perzgjedhjes.**

Nga AK –Zyra e prokurimit ti merr hapat e duhur qe ti largoi te gjitha ato qe i ceka deri me tash por edhe ato nese e din qe jan te teperta per ket projekt,lete vendoset stafi punues dhe mekanizmi ne bazë te natyres se projektit qe ne ket rast e kini vendosja e ndriqimit publik.

Duke unisur nga kto AK –Zyra e prokurimit ka synim qe paraja publike te mos keq

perdoret por te shkoji ne ato vende- ku gjen zbatim ne infrastruktur,kanalizim,ndriqim etj. per te miren e popullates me nji kosto te perballushme te tregut e kjo arrihet qe te ket numer sa me shum te OE pjesëmarrs Ne ofertim sepse krijohet mundsia me zgjedhë OE me te favorshe ne ofertë.

Kerkoi nga ju qe ta riktheni ket dosje ne verifikim te ktyre kritereve te cekura me lart (te largohen), dhe ti vendosni kriteret ne bazë te natyres se tenderit sipas krpp, e qe mos te ka nevoj per ankesa te metejme. Sepse nese e njejta perseritet ne dote vazhdojm proceduren e metejm per kto parregullsi qe i krijohen ne favore personale, dhe mandej landa dote shkoj ne OSHP e me radhë do vazhdoi edhe ne institucionet tjera.

Ju njoftoi se ne si kompani kemi kry shum projekte ne Komunen e Istogut dhe kemi referencë te mirë ne realizim te punve dhe te pergjegjeshem ne kerkesat e AK te ksaj Komune. Ne jemi si kompani per punet e ksaj natyre me staf profesional dhe mekanizem adekuat per kto pun qe është shpall nga kjo komunë,por me kto kritere te vendosura te pa nevojshme po i favorizoni kompanit qe mirren me punë tjera qe dmth. jasht natyres st kti projekti qe është shpallur .

Prandaj këto kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale te parashtruara nga ana juaj, janë të pa nevojshëm, jo relevante me aktivitetin e prokurimit, diskriminues dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-se, te cekura me lartë, sepse këto kritere diskriminuese kufizojnë konku rrencën e hapur dhe te lirë për shumë operator ekonomik te cilët kanë aktivitet primar punët e kësaj natyre.

Kshtu qe kërkojmë qe kërkesat e cekura me lartë ti largoni në mënyrë që vetëm ato të cilat janë relevante me aktivitetin dhe të mbështetura në dispozita ligjore të LPP-se, dhe vetëm ato te cilat koordinohen me paramasen dhe natyrën e këtij projekti qe do te realizohet. Në të kundërtën në pajtim me kërkesat LPP-së do të vazhdojmë me procedurat e ankimimit në shkallë të tjera.

Përfundim:

Kërkojmë nga AK, **KOMUNA E ISTOGUT**, që:

- ✓ Të aprovoj Kërkesën për rishqyrtim të bazuar;
- ✓ Të anuloj njoftimin per kontratë
- ✓ Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat dhe RRPP.
- ✓ Te vendosen kriteret ne peruthshmeri me natyren e projektit te kerkesa mbi mundsin teknike dhe profesionale,te cilat kritere jan prezente ne kontratat paraprake te ksaj natyre.
- ✓ Te kerkohet stafi profesional qe i perket elektroteknikes apo natyres se punimeve,e jo me kerku lloj lloj ingjinjera apo puntor veq per letra e perkunder ksaj kta nuk

ekzistojn ne vend punishte se nuk din qkq me punu,dhe me e keqja e ksaj kta po i rrezikoni nga tensini ju duke tentu qe kta puntor apo inxhinjer pa as nji dit punë pervoj nuk kan me instalime elektrike.

- ✓ Te kerkohet mekanizmi qe hyn drejt perse drejti ne realizimin e kti projekti e jo me pas paisje te pa nevojshme veq ne letra,a zbatimi ityre nuk realizohet sepse ska mundsi.

Mbetemi me shpresë se Kërkesa për Ri-shqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt -**M. Krasniqi** –Perfaqshues ne kompanin **Toni ingjinjering sh.p.k**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative. Shpenzimet e ankimimit 500 €

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.